



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA MALLAKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2978/prot.
2

Ballsh, më 21.06.2024

PROCESVERBAL

I dëgjësës publike për fazën e parë të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

I mbajtur më datë 21.06.2024, në Ballsh me banorë të Ballshit dhe kryetarët e fshatrave të Bashkisë Mallakastër.

Kryetari i këshillit, Z. Nexhmi Sulaj hap këtë dëgjësë publike: Kjo dëgjësë realizohet për të informuar juve mbi parashikimet e P.B.A-së 2025-2027, por gjithashtu të marrim sygjerimet dhe opinionet tuaja që t'i paraqesim në fazat pasardhëse të projektakteve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Z. Qerim Ismailaj: Mbas kalimit të buxhetit 2024, bëhet parashikimi i P.B.A-së 2025-2027, që ka një afat tre vjeçar.

Sot po bëjmë fazën e parë, pra parashikimi për projektet që kemi në diskutim. Një prioritet i madh pritet t'i jepet aksit rrugor Patos- Ballsh, nuk është konfirmuar akoma. Jemi në bashkëpunim me Bashkinë e Beratit për realizimin e një rruge lidhëse Mallakastër-Berat, ndoshta nga Aranitasi për në Sinjë, ose lidhja e Lumarës me Osmënzëzën. Këto janë dy prioritete, por në këtë parashikim tre vjeçar kemi gjithashtu synim realizimin e çdo aksi rrugor që ka ngelur pa rikonstruktuar, po punohet me projekte për të thithur fonde nga FSHZH, por në bashkëpunim me bashkinë për vlerat e kolaudimit dhe mbikqyrjes.

Janë parashikuar dy ujësjellësa:

- Drenovë, Visokë
- Aranitas-Kalenjë-Panahor; jemi në dijeni që më herët janë ndërtur linja për Kalenjë, të cilat s'janë vënë në funksion, por projekti i ri i shmang këto linja.

Po zgjidhëm financimin e projekteve të këtyre dy ujësjellësave kemi zgjidhur gjithë problemin me ujin e pijshëm.

Një përkrahje të madhe do t'ju japim familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike

Do kërkoja nga kryetarët e fshatrave bashkëpunim për ndërgjegjësimin e banorëve për pagesën e tarifave për shërbimet që marrin, sepse duke mbledhur të ardhura bëjmë të mundur realizimin e këtyre investimeve që kemi parashikuar.

Z.Gani Goxhaj: Përparësi t'u jepet edhe rrugëve nëpër parcela, sepse ne nga tokat i marrim të ardhurat.

Z.Qerim Ismailaj: Keni shumë të drejtë, por aktualisht është e pamundur, një arsye është ndarja jo e rregullt e parcelave dhe kemi akoma shtatë fshatra të paazhurnuar, plus dhe terreni kodrinor i Mallakastrës.

40% I parashikimeve të buxhetit shkon për rikonstruksion rrugësh, dikush do rrugën e fshati, dikush rrugën e tokës bujqësore, por primare është rruga kryesore që ambulance të shkoj te shtëpia e gjithësecilit prej nesh.

Realizuaam rrugën Panahor-Ngraçan katër kilometra, por duhen akoma dhe 1,4 km për të bërë lidhjen me një aks tjetër.

Realizuaam rrugën e fshatit Çyçen, se vë në dyshim që duhen dhe rrugët bujqësore, por sipas prioritetit, në fillim të shkoj ambulance dhe zjarrëfikësja te shtëpia, pastaj të shkosh te ulliri në toka.

Jemi të vetdijshëm që procesi i tokave bujqësore do vite , sepse problem i parë është që mbas ndarjes nuk ka rrugë në hartë.

Z.Isuf Serjanaj: Rruga për në Bardhaj,Çerrilë, ka problem, nuk kalon dot makina, dhe skemi furnizim me ujë.

Z.Qerim Ismailaj: Po e di që ka nevojë për furnizim me ujë në Bardhaj, por momentalisht kemi zona me problematike sot për ujë, siç janë Visoka dhe Drenovat, kjo s'do të thotë që zonat e tjera s'janë, por s'mund të japim një premtim që për momentin nuk e kemi lluksin të realizojmë nje projekt milione euro në Bardhaj për 5 familje, se është e lehtë të premtosh por jo të ballafaqohesh.

Kryetari i fshatit Gjerbës, Z.Xhafo Murataj: Duke filluar nga Aranitasi në Kalenjë, një makinë rërë duhet, ne banorët e zonës, 40 familje, kemi shprehur propozimin te ju për t'a realizuar vetë rrugën me lekët tona për materialet që duhen dhe ju si bashkia të na vini në dispozicion mjetet.

Z.Qerim Isamilaj: Bashkia ka interes që ta miratoj një herë një model të till dhe pse jo që t'a realizoj, por ju e bëtë këtë si kërkesë dhe e lat në hije, nuk u bë asnjë procedurë.

Kryetari i fshatit Ngraçan, Z.Sabri Saliaj: Puna e kryer në rrugën që ju përmendët Panahor-Ngraçan nuk është sipas standartit, ju lutem e verifikoni.

Z.Muharrem Hajdëraj: Greshica e ka linjën e ujit të pijshëm që nga vitet'80 dhe marrim ujë vetëm 20 minuta në ditë.

Z.Qerim Ismailaj: para se të vinim këtu e kemi diskutuar me përgjegjës të ujësjellësit këtë shqetësim dhe do marrim masa për përirësim.

Z.Gëzim Sinanaj, kryetari i fshatit Çyçen: Në lagjen Goxhaj, si rrugën dhe ujin, i ka shumë afër pikat fundore, pse nuk bëhet lidhja e kësaj lagjeje dhe me ujë dhe me rrugën?

Z.Isuf Serjanaj: Një shqetësim shumë të madh kemi mungesën e një qendre shëndetësore.

Z.Qerim Ismailaj: Qendrat shëndetësore janë pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, por do ta ngrem si shqetësim, jemi në negociata, kur të kalojmë në faza konkrete do informoheni.

Z.Novrus Harrunaj: Kërkesat që kemi pasur në të Panahorit I kemi drejtuar te ju, faleminderit për ato që keni realizuar dhe shpesojmë të realizohen të tjera.

Z. Bedri Aliaj: Jam anëtar i Belishovës së Re, çfarë projektsh do zhvillohen në zonën tonë për ujin dhe rrugët?

Z.Qerim Isamilaj: U ngritën si shqetësim ujësjellësat e këtyre zonave dhe janë prioriteti ynë.

Por pa diskutim që kemi dhe problematika të tjera, a jemi në gjendje t'i realizojmë me këto fonde, dhe pse financimet nga qeveria nuk na kanë munguar, shpresojmë të realizojmë sa më shumë projekte dhe të sjellim përmirësimin e jetesës në secilin fshat të Mallakastrës.

Z.Nexhmi Sulaj: Kjo ishte faza e parë, faza tjetër do jetë në tetor, shpresoj të merrni pjesë, faleminderit për pjesëmarrjen!

MBAJTËS TE PROCESVERBALI

KOORDINATORI PËR NJOFTIMIN DHE

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

KOSULTIMIN ME PUBLIKIKUN

Zinajda Ahmetaj

Rovena Osmënaj